



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:006213
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05740843

Kom.Dh.Shk.II.nr.502/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit N.P.SH. “ARCH & DESIGN”, me seli në Viti, rr. “Tiranës”, të cilën e përfaqëson M.I. përfaqësuar me autorizim nga Liman Musa., avokat nga Ferizaj, kundër debitorit “Nderimi” Sh.P.K, me numër të regjistrimit të biznesit 70201458, me seli në rrugën Magjistrale Ferizaj – Prishtinë, Ferizaj, me bashkëpronarë Sh.A. dhe H.R., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Burhan Qosaj., avokat nga Ferizaj, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.2039/22 i datës 15.11.2023, me datë 28.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit N.P.SH. “ARCH & DESIGN”, me seli në Viti, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.2039/22 i datës 15.11.2023, **PRISHET** dhe çështja i kthehet Gjykatës Komerciale, dhomave të shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

1 (5)

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.2039/22 i datës 15.11.2023, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, “Nderimi” Sh.P.K, me numër të regjistrimit të biznesit 70201458, me seli në rrugën Magjistrale Ferizaj – Prishtinë, Ferizaj, dhe ka anuluar Urdhrin Përmbarimor P.nr.137/2018, i lejuar më datë 28.03.2018, nga Përmbaruesi Privat Mubarak Shumolli ashtu që është përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore. Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori N.P.SH. “ARCH & DESIGN”, me propozimin që aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.2039/22 i datës 15.11.2023, ta anulojë dhe që Urdhrin e Përmbaruesit Privat të anulojë dhe propozimin për përmbarim ta refuzojë si të pa bazuar.

Kreditori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm, faturë nr.02/2018 e datës 05.01.2018, duke urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri, t’ia paguaj kreditorit tërësisht borxhin prej 5,580.00 €, me kamatëvonesë 8 % vjetore nga data 28.03.2018, e deri në pagesën e plotë, si dhe shpenzimet e përmbarimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm si dhe në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim, paguhet taksa në shumë prej 104.00 € sipas tarifës së OAK.

I autorizuari i debitorit, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim ndaj urdhrin përmbarimor me të cilin ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor për faktin se i njëjti nuk mund të konsiderohet dokument i besueshëm. Ka theksuar se debitori i ka borxh kreditorit vetëm shumën prej 4,260.00 euro sipas ditarit të punës, ku dhe debitori përmes e-mailit por edhe me telefon i ka kërkuar të vijë pran ndërmarrjes ku pas kontrollit të ditarit të punës të bëjë edhe faturën për pagesë. Me propozim për gjykatën që të pranojë si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të anulojë urdhrin P.nr.137/18 të datës 28.03.2018 I autorizuari i kreditorit në përgjigjen e ushtruar me shkrim, në prapësimin e debitorit i ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim P.nr.137/2018 duke theksuar se borxhi i

debitorit ndaj kreditorit nuk është siç pohon debitori në vlerë prej 4,260.00 euro, por është 5,580.00 euro dhe se kreditori në propozim ka paraqitur gjendjen reale të punës lidhur me këtë ka shkëmbyer edhe e-mail me debitorin dhe atë me datë 24.03.2018, me datë 16.11.2017 dhe komunikimi Revidim të Projekteve Kryesore të shtëpive në lagjen “Panorama Residence”, Ferizaj të datës 13.11.2017.

Gjykata Themelore në Ferizaj me Aktvendimin PPP.nr.37/18 të datës 20.06.2018 ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit sa i përket shumës prej 4,260.00 euro dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor për shumën e borxhit në vlerë prej 5,580.00 euro, ndërsa ka refuzuar prapësimin e debitorit për shumën e borxhit prej 1,320 euro dhe për këtë pjesë të borxhit ka lënë në fuqi urdhrin përmbartimor.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin Ac.nr.3411/2018 të datës 22.12.2021 ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit, ashtu që ka anuluar Aktvendimin PPP.nr.37/18 të datës 20.06.2018, dhe lëndën i ka kthyer të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm. Në rivendosje lënda fillimisht ka marrë numrin PPP.2/22(2022:006213), ndërsa pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale të Kosovës, është transferuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj për në Gjykatën Komerciale të Kosovës për shqyrtim të mëtejme në bazë të kompetencës lëndore, dhe e njëjta ka marrë numrin KPPP.nr.2039/22. Gjykata, sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, të dhëna në vendimin Ac.nr. 3411/2018 të datës 22.12.2021, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore në lidhje me këtë çështje përmbartimore në të cilën kanë qenë prezent përfaqësuesit e autorizuar të palëve ndërgjyqëse.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar, përgjigjes së kreditorit në prapësim, deklarimeve të palëve ndërgjyqëse gjatë seancës publike dëgjimore, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, me të cilin ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, “Nderimi” Sh.P.K, me numër të regjistrimit të biznesit 70201458, me seli në rrugën Magjistrale Ferizaj – Prishtinë, Ferizaj, dhe ka anuluar Urdhrin Përmbartimor P.nr.137/2018, i lejuar më datë 28.03.2018, nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli ashtu që është përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Në arsyetim të aktvendimit Gjykata e Shkallës së Parë ka vlerësuar se gjeti se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i

besueshme dhe nuk i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Gjykata Komerciale , Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika n), neni 183 dhe 184 të LPK-së.

Aktvendimi i atakuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet meqë dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten si dhe me arsyetimin e aktvendimit. Në aktvendimin e atakuar ekzistojnë fakte vendimtare në kundërtënie midis asaj që në dispozitiv të aktvendimit thuhet për përmbajtje të dokumentit, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka pas parasysh faktin se debitori pas seancës dëgjimore ka bërë një pjesë të pagesës në shumën prej 4,260.00€ nga fatura 2/2018 për të cilën është iniciuar procedura përmbarimore. Gjykata e shkallës së Dytë vlerëson se pagesa e pjesshme e faturës nënkupton se debitori e ka pranuar faturën si të tillë dhe shërbimin e ofruar të cilën e përmban e njëjta, respektivisht prestimin sipas faturës. Andaj, Gjykata e Shkallës së Parë është dashur ta vlerësoj këtë rrethanë pavarësisht faktit që fatura kontestuese nuk ka qenë e nënshkruar dhe vulosur.

Gjykata, vlerësoj edhe pretendimet tjetra të debitorit se mosmarrëveshjet lidhur me realizimin e punëve të kontraktuara, mirëpo të njëjtat nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, pasi që Gjykata, në procedurën përmbarimore e cila i nënshtrohet rigorozitetit formal, kufizohet vetëm në vlerësimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi, ndërsa pretendimet e natyrës materiale, lidhur me cilësinë se mallrave të ofruara nga kreditori, debitori mund t'i paraqes në kontest të rregullt civil.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë është dashur të vlerësoj faturën e lartcekur nëse i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 27 par 1 dhe të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, nëse dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim andaj, edhe nga këto arsye është dashur që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe çështja ti kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që të bëjë eliminimin e shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore në pajtim me vërejtjet e paraqitura, ashtu që të vlerëson në mënyrë të drejtë dokumentin përmbarimor nëse i njëjti sipas dispozitave ligjore i

plotëson kushtet si dokument përmbarues, e pas kësaj të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm konform dispozitave të LPP-së.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkalles se Dytë

K.DH.SH.II nr.502/24, me datë 28.05.2024

Gjyqtarja,
Saranda Bogaj Sheremeti